

Edicioni i 2<sup>të</sup>

27-29  
Prill 2017

*Panairi i Shkollave &  
Aftësive Profesionale.*

Me mbështetjen e



## “Olimpiada e Aftësive 2017” Panairi i Shkollave dhe Aftësive Profesionale

### Çfarë përfaqëson Arsimi dhe Formimi Profesional -AFP

- Shanse më të mëdha punësimi
- Të rinj të mirëorientuar
- Shkolla moderne
- Partneritet i qëndrueshëm me biznesin
- Ekonomi më e qëndrueshme
- Integrim Evropian i Arsimit Profesional
- Partnerë të denjë në tregun evropian dhe global





Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në angazhimin e saj institucional për modernizimin dhe rritjen e cilësisë në Arsimin Profesional, organizon edicionin e dytë të “Olimpiadës së Aftësive”.

Ky aktivitet tregues, krahas promovimit të shkollave të Arsimit Profesional, do të krijojë hapësira të reja dhe bashkëpunim ndërmjet shkollave dhe aktorëve të sektorit të biznesit.

## Çfarë? Qëllimi? Kur? Ku ?

### • Çfarë

“Olimpiada e Aftësive 2017”  
Panairi i Shkollave dhe aftësive  
Profesionale

### • Qëllimi

Arsim dhe Formim Profesional  
më cilësor, më pranë biznesit

### • Kur

Në datat 27 - 29 Prill

### • Ku

Expo City - Pranë CityPark



## Institucionet dhe Kategoritë Ekspozuese



- Shkolla të mesme profesionale publike dhe private
- Shkolla të mesme profesionale nga rajoni
- Qendra të formimit profesional publike dhe private
- Institucione të arsimit të lartë nga vendi dhe rajoni
- Kompani private që ofrojnë mundësinë e praktikave profesionale
- Agjenci punësimi
- Biznese të interesuara për partneritet me AFP-në

## Panairi i Shkollave dhe qendrave Profesionale

- Objektivi final i këtij aktiviteti është arritja e një bashkëpunimi midis profesionistëve më të spikatur, duke promovuar ofertën e arsimit profesional si mënyrë për rritjen e ekonomisë dhe punëzënies përmes kualifikimit të burimeve njerëzore.
- Panairi vjen si promovim i arritjeve të deritanishme dhe është në funksion të këshillimit të karrierës për të gjithë maturantët.
- Nxitje dhe motivim të konkurrencës profesionale
- Mundësi për bashkëpunim ndërmjet shkollave dhe biznesit



## Bëhuni pjesë e Panairit

Tregu i punës karakterizohet nga një mospërputhje kërkesë dhe ofertë, ku statistikat flasin për një numër të madh ofertash pune që kërkojnë punonjës të specializuar dhe profesionistë, por që kanë mungesë të një praktike profesionale dhe eksperience pune.

Strategjia e Ministrisë ka pasur si synim pikërisht amortizimin e kësaj mospërputhjeje dhe aftësimin e të rinjve, duke ndikuar drejtpërdrejt në punësimin e tyre. Në këtë drejtim, Panairi ju ofron mundësinë:

- Të prezantoni drejtimet profesionale, profilet dhe praktikat e ndryshme të ofruara në Institucionin tuaj.
- Të bashkëpunoni me kompani, të cilat kërkojnë profesionistë dhe mundësojnë kontrata punësimi dhe praktika profesionale;
- Të prezantoni ofertat për punësim në biznesin tuaj duke pasur mundësinë të realizohen intervista për vendet vakante direkt në panair;
- Të krijoni marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet e AFP-së, me qëllim rekrutimin e nxënësve sipas nevojave të biznesit tuaj për burime njerëzore.

# Programi i Panairit

Edicioni i dytë nën sloganin “Unë zgjedh Arsimin Profesional”

Gjatë ditëve të Olimpiadës janë planifikuar konferenca, tryeza të rrumbullakëta me grupet e interesit dhe konkurse në profile të ndryshme profesionale, të cilat do të prezantojnë modelet më të suksesshme në sistemin e AFP-së dhe njëkohësisht do të vlerësojnë ekselencën dhe rezultatet e arritura.

Drejtimet kryesore të përzgjedhura për këtë edicion të dytë të konkursit janë:

- Bujqësi (Kopshtari)
- Teknologji Informacioni dhe komunikimi (TIK)
- Elektroteknikë (instalime civile dhe industriale)
- Hoteleri-Turizëm
- Rrobaqepësi
- Ndërtim
- Përpunim Druri
- Termohidraulikë



Autostrada Tiranë-Durrës, KM 8, pranë City Park.  
Për përpilimin e Kontratës dhe informacione të tjera  
kontakttoni në:

**Cel:** +355 66 40 40 740 | **Tel:** +355 42 387 080  
**e-mail:** exhibitor@expocity.al | **web:** www.expocity.al

